

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sorbeto me garniture me milingona të zeza në restorantin me 2 yje 'Mishelin', pronarja gjobitet 11 mijë d ollarë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/17/sorbeto-me-garniture-me-milingona-te-zeza-ne-restorant-in-me-2-yje-mishelin-pronarja-gjobitet-11-mije-dollar/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 15:18:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 15:14:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 15:13:00 UTC → 17 shtator 2026, 15:15:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	399fc1ef9b054b57df6a53246d328b510185753bf29b38ddbb748a3ac3c5df97
TEKSTI	d81db7a8d22f6b93869b927964ee70b46354dc959314cd0fb29aa292f9507555
PAMJA	56793dd893ca0a5bb99819cbbb3f6554df1299f8185c81c439e68098ad2b5fa

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b7ac81c85adbc2027363cf476dd123b4979d158141cd46c4a0c459d87b010c9f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7da1a16455667271a66d1d30122b5a20135397a682b3b58f5cc074dfa4984ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te bllok, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b7ac81c85adbc2027363cf476dd123b4979d158141cd46c4a0c459d87b010c9f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POP NEWS TË FUNDIT

Sorbeto me garniture me milingona të zeza në restorantin me 2 yje 'Michelin', pronarja gjobitet 11 mijë dollarë

17/09/2026 17:14



Pronarja e një restoranti me dy yje 'Michelin' në Korenë e Jugut i ka shpëtuar dënimit me burg në një çështje të bujshme, që lidhej me një ëmbëlsirë të tipit sorbet, të dekoruar me milingona.

Më 16 shtator, Gjykata e Qarkut Perëndimor të Seulit e gjobiti pronaren e restorantit me 11 mijë dollarë. Ajo u identifikua vetëm si një grua me mbiemrin Kim, ndërsa emri i restorantit nuk u bë publik. Ndërkohë shefi i kuzhinës së restorantit nuk u akuzua për asnjë shkelje.

CNN shkruan se, prokurorët kishin kërkuar një dënim me një vit burg për pronaren dhe një gjobë prej 13.580 dollarë, duke iu referuar një fitimi prej 81.470 dollarë gjatë katër viteve të fundit.

Problemi nuk qëndron te fakti se në menu u shfaqën insekte.

Çështja lidhet më tepër me rregulloret specifike të Koresë së Jugut për ushqimin, të cilat përcaktojnë se cilat insekte lejohen të shërbehen në pjatat e klientëve.

Në korrik, zyra e prokurorit deklaroi për CNN se restoranti në fjalë kishte shërbyer milingona të thara, të importuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Tajlanda, që nga viti 2021.

Ata pretenduan se restoranti kishte shërbyer rreth 49,000 milingona në 12,200 porcione të ëmbëlsirës sorbet.

Sipas qeverisë, problemi nuk ishte thjesht prania e milingonave në ushqim. Ministria e Sigurisë së Ushqimit dhe Barnave deklaroi se hetuesit "zbuluan se milingonat e përdorura nga ky restorant përmbanin nivele metalesh të rënda deri në 55 herë më të larta se kufiri maksimal i lejuar për insekte të tjera të ngrënshe".

Gjatë dhënies së vendimit, gjykatësi vuri në dukje se ekzistonte një rrezik i mundshëm për shëndetin, pasi në milingonat e shitura nga restoranti ishin gjetur metale të rënda mbi nivelet e lejuara.

Megjithatë, gjatë përcaktimit të dënimit, gjykatësi mori parasysh faktin se sasia e milingonave të përdorura dukej të ishte më e vogël se ajo e llogaritur nga prokurorët, si dhe faktin se Kim nuk kishte precedentë penalë të mëparshëm.

Sipas Ministrisë së Sigurisë së Ushqimit dhe Barnave të Koresë së Jugut, ky produkt me bazë milingonash importohet nga Tajlanda.

Aktivistët në Korenë e Jugut dhe jo vetëm kanë argumentuar gjithnjë e më shumë se insektat ishin një burim proteinash në një kuzhinë tradicionale të kësaj zone.

POP NEWS • TË FUNDIT




Kim Kardashian dhe Lewis Hamilton arratisje romantike në Ligenin e Komos, çifti fotografohet në një varkë



"Nuk na ka paguar prej 6 muajsh", avokatët e Diddy-t kërkojnë tërheqjen nga padia për shpifje



Miliarderi padit aktoren kineze dhe prindërit e saj: U dhashë 4.5 milionë dollarë për martesën, më kërkuar 50 milionë për fëmijën



"Sot më dhemb Kosova"/ Nga Luiz Ejlli te Elvana Gjata, VIP-at shqiptarë reagojnë pas vendimit të Hagës ndaj ish-krerëvetë UÇK-së

ME TË LEXUARAT

"Jam një djalë i ri dhe kam një lidhje me një burrë të martuar"/ Moderator i lexon mesazhet e tradhtive: Kam puthur kunatin...

Foto/ U arrestua për vjedhje, 35-vjeçarja bëhet virale për ngjashmërinë e madhe me divën e muzikës pop

Pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së, Richard Grenell publikon foton e Bleona Qeretit me bluzën kuqezi

insektet janë një burim proteinash po aq i rëndësishëm sa produktet e qeta shtazore.

Duke pasur parasysh lehtësinë me të cilën ato rriten dhe mblihen – duke kërkuar më pak burime sesa blegtoria tradicionale – insektet ofrojnë një mënyrë efektive për të luftuar ndryshimet klimatike.

Megjithatë, sipas ligjit të vendit për Higjienën e Ushqimit, vetëm 10 lloje insektesh, përfshirë karkalecat dhe krimbat e mëndafshit, lejohen për konsum njerëzor. Shërbimi i çdo lloji tjetër insekti, siç janë milingonat, kërkon miratim të veçantë nga autoritetet.

Ndërkohë mediat lokale raportuan se, avokatët që përfaqësojnë restorantin thanë se shefi i kuzhinës përdori milingona për t'i dhënë aciditet pjatës, pa e ditur se receta që kishte përdorur dikur në SHBA dhe Evropë është e ndaluar me ligj në Korenë e Jugut.

Ata shtuan gjithashtu se restoranti u shërbeu milingona vetëm rreth 60% të klientëve dhe se prania e tyre ishte e shënuar qartë në menu si pjesë e pjatës.

Top Channel

I Pop News »



Të gjitha rrugët të çojnë në Madrid: Ja pse kryeqyteti spanjoll u bë pikëtakimi i botës në fundjavën që lamë pas

17/09 17:09




Pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së, Richard Grenell publikon foton e Bleona Qeretit me bluzën kuqezi

17/09 17:08



Foto/ U arrestua për vjedhje, 35-vjeçarja bëhet virale për ngjashmërinë e madhe me divën e muzikës pop

17/09 14:38



"Jam një djalë i ri dhe kam një lidhje me një burrë të martuar"/ Moderator i lexon mesazhet e tradhtive: Kam puthur kunatin...

17/09 14:28



Kim Kardashian dhe Lewis Hamilton arratisje romantike në Liqenin e Komos, çifti fotografohet në një varkë

16/09 22:46



"Nuk na ka paguar prej 6 muajsh", avokatët e Diddy-t kërkojnë tërheqjen nga padia për shpifje

16/09 22:41

Të gjitha rrugët të çojnë në Madrid: Ja pse kryeqyteti spanjoll u bë pikëtakimi i botës në fundjavën që lamë pas

Kim Kardashian dhe Lewis Hamilton arratisje romantike në Liqenin e Komos, çifti fotografohet në një varkë

"Nuk na ka paguar prej 6 muajsh", avokatët e Diddy-t kërkojnë tërheqjen nga padia për shpifje

"Sot më dhemb Kosova"/ Nga Luiz Ejlli te Elvana Gjata, VIP-at shqiptarë reagojnë pas vendimit të Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Miliardi për aktoren kineze dhe prindërit e saj: U dhashë 4.5 milionë dollarë për martesën, më kërkuar 50 milionë për fëmijën

Bonnie Greer, shkrimtarja britaniko-amerikane, ndahet nga jeta në moshën 77-vjeçare

"Palestina e lirë", deklarata që nxiti largimin e Macklemore nga turneu i Ed Sheeran, artistët e tjerë e bojkotojnë

Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/Financat publike në rrezik, Tabaku: Taksat paguhet në mënyrë jo transparente, të gjithë...



Top Channel/ Vendimi për krerët e UCK, Koçeku sulmon qeverinë: Nuk ka punuar për interesin kombëtar



Top Channel/ Kryemadhi këshillon protestuesit para SPAK: Strukturon lëvizjen, mos bëni si partitë



Top Channel/ Bledi Hoxha



Top Channel/ UÇK në bashkëpunim



Top News - BE dhe Kanada, më të

